



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

QENDRA E PARANDALIMIT TË  
KRIMEVE TË TË MITURVE DHE TË  
RINJVE

Nr. 93 prot.  
Tiranë, më 15.04. 2022

NISMA PËR NDRYSHIM  
SHOQËROR ARSIS

Nr. 45 prot.  
Tiranë, më 15.04. 2022

**MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI**

**NDËRMJET**

**QENDRËS SË PARANDALIMIT TË KRIMEVE TË TË MITURVE DHE  
TË RINJVE (QPKMR)**

**DHE**

**ORGANIZATËS JOFITIMPRURËSE “NISMA PËR NDRYSHIM  
SHOQËROR ARSIS”**

**“Për**

**ofrimin e shërbimeve në kuadër të rehabilitimit dhe riintegrit të të miturve  
dhe të rinjve në konflikt me ligjin”**

Sot, më datë \_\_\_\_\_.\_\_\_\_ 2022, në Tiranë, lidhet kjo Marrëveshje Bashkëpunimi ndërmjet palëve:

**Qendra e Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve** (më poshtë “QPKMR”), përfaqësuar nga Znj. Klaudia HASANLLARI, me adresë Bulevardi “Zog I - rë”, Tiranë dhe e-mail: [qpkmr@drejtesia.gov.al](mailto:qpkmr@drejtesia.gov.al).

*dhe*

**Shoqata “Nisma për Ndryshim Shoqëror-ARSIS”**, (më poshtë “NISMA”), përfaqësuar nga Znj. Ana MAJKO, Drejtore Ekzekutive, me adresë “Rruga e Kavajës”, Pallati A, Shkalla 3, Ap.27, Njësia Administrative nr.7, PC 1023, Tiranë, Shqipëri, dhe e-mail: [initiative.arsis@gmail.com](mailto:initiative.arsis@gmail.com).

Duke qenë se Palët:

*Vlerësojnë* rëndësinë e përmirësimit të administrimit të drejtësisë penale për të miturit në konflikt me ligjin në kuadër të forcimit të shtetit të së drejtës dhe përmirësimit të respektimit të të drejtave të njeriut;

*Konsiderojnë* se një ndër objektivat kyç në ushtrimin e veprimtarisë së institucioneve në nivel qendror dhe vendor është efikasiteti në ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve në përputhje me nevojat e tyre;

*Marrin në konsideratë* politikat e ndjekura dhe masat e ndërmarra në nivel legjislativ për të mbrojtur dhe garantuar të drejtat e të miturve në konflikt me ligjin dhe kërkesat për implementimin e suksesshëm të tyre;

*Synojnë* implementimin efektiv të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur nëpërmjet mbrojtjes së interesit më të lartë të të miturve, integritit social dhe rehabilitimit të të miturve në konflikt me ligjin, viktimave dhe dëshmitarëve;

*Konfirmojnë* angazhimin institucional për të siguruar standarde të larta të veprimtarisë dhe për të adresuar nevojat e strukturave zbatuese të ligjit për drejtësinë për të miturit për pasjen e një kuadri institucional dhe infrastrukturor mbështetës në qasje me objektivin e drejtësisë miqësore për fëmijët;

*Njohin faktin* se NISMA po zbaton projektin “Vazhdim i mbrojtjes së menjëhershme të fëmijëve në rrezik të lartë viktimave të abuzimit, trafikimit, neglizhimit dhe shfrytëzimit” (EN: “*Continuum of immediate protection of children at high-risk victims of abuse, trafficking, neglect, and exploitation*”), financuar nga UNICEF;

*Marrin në konsideratë se NISMA ka një eksperiencë të gjatë në trajtimin psikosocial të fëmijëve në konflikt me ligjin, gjatë procesit të intervistimit në ambientet e komisariateve në Bashkinë Tiranë dhe Kamëz, si dhe ofron programe riintegrimi për fëmijët në konflikt me ligjin pranë Qendrës multifunkionale “Shtëpia e Ngjyrave” në Bashkinë Tiranë;*

*Afirmojnë vullnetin dhe vendosmërinë për të bashkëpunuar dhe kontribuar në realizimin e qëllimit të kësaj marrëveshjeje, për të përmbushur angazhimet e ndërmarra në kuadër të instrumenteve ndërkombëtare, si dhe legjislacionit shqiptar në fuqi;*

*Kanë rënë dakord të lidhin këtë Marrëveshje Bashkëpunimi, në vijim e quajtur Marrëveshje.*

## Neni 1

### **Qëllimi i Marrëveshjes**

Kjo marrëveshje ka për qëllim përcaktimin e mënyrave të bashkëpunimit midis Organizatës “Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS” dhe Qendrës së Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve (QPKMR) për të siguruar përkrahje juridike, psikologjike e sociale.

## Neni 2

### **Baza Ligjore**

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi bazohet në ligjin nr. 37/2017 “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur”; ligjin nr.18/2017, “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen dhe e Fëmijës”; ligjin nr. 121/2016, “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë; VKM nr. 353, datë 12.06.2018 “Për rregullat e funksionimit të grupit teknik, ndërsektorial për mbrojtjen e fëmijëve, pranë bashkive dhe njësive administrative”; VKM nr.148, datë 13.03.2018 “Për përcaktimin e rregullave të bashkëpunimit ndërmjet mekanizmave këshillimorë e koordinues institucionalë, strukturave për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës dhe organizatave jofitimprurëse, për realizimin e politikave kombëtare e vendore, si dhe për shërbimet e nevojshme për mbrojtjen e fëmijës”; VKM nr. 635, datë 26.10.2018 “Për veprimtarinë e strukturave për mbrojtjen e fëmijës, në lidhje me fëmijën nën moshën për përgjegjësi penale, që dyshohet apo ka kryer veprë penale”, si dhe VKM nr. 314, datë 15.05.2019, “Për organizimin, funksionimin, si dhe përcaktimin e rregullimeve specifike lidhur me strukturën dhe organikën e Qendrës së Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve”.

## Neni 3

### **Kohëzgjatja e marrëveshjes**

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi lidhet për një periudhë 1 (një) vjeçare me të drejtë ripërtëritjeje.

## Neni 4

### Detyrat e palëve

#### 1. Qendra e Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve (QPKMR) angazhohet:

- a) Të hartojë dhe të dërgojë një letër referencë për të miturit që kanë përfunduar ose janë duke vuajtur dënimin, në të cilën evidentohet nevoja për asistencë psikologjike dhe shërbime të tjera që NISMA disponon, si dhe të komunikojë me personin përgjegjës nga NISMA për ndjekjen e rasteve.
- b) Të bashkëpunojë me NISMA për monitorimin e zbatimit të programit individual të trajtimit psiko-social të të dënuarit të mitur, gjatë gjithë periudhës kohore të nevojshme pas përfundimit të dënimit.
- c) Të ndajë me NISMA praktikat më të mira në lidhje me objektivat e përcaktuara në Marrëveshje.
- d) Të marrë pjesë në takime dhe tryeza të përbashkëta, të cilat zhvillohen nga NISMA në kuadër të rritjes së kapaciteteve në lidhje me zbatimin e legjislacionit për masat alternative.

#### 2. Nisma për Ndryshim Shoqëror (ARSIS) angazhohet:

- a) Të zhvillojë një model ndërhyrjeje pozitive në lidhje me ofrimin e shërbimit psiko-social për të miturit në kontakt me ligjin.
- b) Të ofrojë shërbim psikologjik për të miturit pas kryerjes së dënimit dhe të raportojë rregullisht mbi ecurinë e shërbimit të ofruar.
- c) Të vendosë në dispozicion pranë Qendrës multifunktionale “Shtëpia e Ngjyrave” një ambient të dedikuar për ofrimin e shërbimit psiko-social.
- d) Të komunikojë dhe informojë me shkrim QPKMR-në për çështje që mund të dalin gjatë zbatimit të projektit me të miturit.
- e) Të organizojë takime ndërsektoriale në bashkëpunim me QPKMR për trajtimin e rasteve më shërbime të nevojshme për integrimin e të miturve në komunitet.
- f) Të asistojë QPKMR-në në fushatat sensibilizuese në shkolla me qëllim ndërgjegjësimin dhe informimin e të miturve mbi edukimin ligjor, etj.

## Neni 5

### **Personat e Kontaktit**

1. Secila nga palët përcakton një person kontakti të cilës/it i drejtohen të gjithë komunikimet, qofshin verbale apo të shkruara, elektronike ashtu edhe të shtypura.
2. Në çastin e nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje, personat e kontaktit janë si vijon:
  - a) Për NISMA: Z. Ditmir LITA, Koordinator, me numër kontakti Cel: 0698527911.
  - b) Për QPKMR: Znj. Klaudia HASANLLARI, Drejtor, me numër kontakti Cel: 0688751513.
3. Këta persona do të jenë përgjegjës gjithashtu për saktësinë e protokolleve, procesverbaleve dhe çdo dokumenti tjetër të nevojshëm.
4. Në rast të ndryshimit të njërit nga këta persona, pala e cila përfaqësohet prej këtij personi, duhet të sigurohet që të njoftojë me shkrim palën tjetër nënshkruese brenda 5 (pesë) ditësh, për të dhënat e personit të ri të kontaktit.

## Neni 6

### **Konfidencialiteti**

1. Palët, në dijeni të përgjegjësisë së tyre ligjore, zotohen të respektojnë dhe të ruajnë etikën profesionale dhe konfidencialitetin e informacionit për secilin nga rastet objekt të bashkëpunimit midis tyre.
2. Në qoftë se nevojitet, në funksion të interesit më të lartë të fëmijës, njëra palë mund t'u kalojë informacionet e përftuara mbi personat subjekt i kësaj Marrëveshjeje (Neni 1 më lart) palëve të treta, duke njoftuar/sqaruar paraprakisht me e-mail apo shkresë palën tjetër nënshkruese të kësaj Marrëveshjeje në lidhje me këtë veprim.

## Neni 7

### **Përfundimi i Marrëveshjes**

1. Secila nga palët mund të përfundojë këtë Marrëveshje përpara afatit të përcaktuar në nenin 3, duke njoftuar palën tjetër me shkrim, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë

përpara përfundimit të marrëdhënieve të Marrëveshjes, duke dhënë sqarime të hollësishme mbi këtë ndërprerje.

2. Për çdo rast, pavarësisht mënyrës së përfundimit, secila nga palët do të përmbushë të gjitha detyrimet që rrjedhin nga Marrëveshja deri në çastin e ndërprerjes së marrëdhënieve.

Neni 8

### Hyrja në fuqi

Marrëveshja hyn në fuqi nga dita e nënshkrimit të saj.

Neni 9

### Dispozita të fundit

1. Kjo marrëveshje hartohet në 4 (katër) kopje të barasvlershme, nga 2 (dy) kopje për secilën palë, të firmosura nga titullarët dhe të vulosura me vulat zyrtare të institucioneve palë.
2. Marrëveshja mund të ndryshohet vetëm nëpërmjet një dokumenti me shkrim të nënshkruar nga të dyja palët.

**PËR**

**QENDRËN E PARANDALIMIT  
TË KRIMEVE TË TË MITURVE  
DHE TË RINJVE (QPKMR)**

**DREJTOR**

**KLAUDIA HASANLLARI**



**PËR**

**NISMËN PËR NDRYSHIM  
SHOQËROR ARSIS**

**DREJTOR EKZEKUTIV**

**ANA MAJKO**

